REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 930/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**633-20-5698-5-2-1**
Nr i brendshëm	**633-020-092-521**

Sa i përket tenderit për: **FASADIMI I NDERTESAVE TE BANIMIT NE BASHKPRONESI TE PARALUFTES.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

LOSHI-DESIGN
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Gurakoc
(Adresa)

Istog ***31000***
(Vendi) *(Kodi postar)*

044-208 136
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Valmir Loshi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

loshi-design@hotmail.com
(Adresa elektronike)

11.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

NDËRMARRJA NDËRTIMORE TREGTARE LOSHI ISTOG

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 23.09.2020 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 09.10.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK: 27.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim e dt:30.10.2020 Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim:04.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa tiprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar AK-ja me dt. 27.10.2020 e ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm, ndërsa e ka rekomanduar për kontratë OE **ADI TE CONSTRUCTION SH.P.K.**

Ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë nga ana e AK-së pasi që nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT-së përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale neni 9.1&9.2 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë "*Kërkesa 2 – Operatori Ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhoj staf teknik te mjaftueshëm dhe atë min. 10 punëtorë.*", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*Dëshmia 2 - Lista e punëtorëve nga ATK, së paku për 3 muajt*

e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë; për stafin e angazhuar për këtë projekt i cili nuk është në marrëdhënie pune me OE ofertues, si dëshmi-të paraqiten lista e punëtoreve dhe kontratat për projektin në fjalë."

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë pasi që listën e punëtorëve nga ATK-ja të cilën e ka prezantuar në ofertën e tij, ne dyshojmë që në atë listë ka ndërhyrje, pasi që shihet qartë se punëtorët Valon Alitaj, Bujar Syla dhe Leonis Ademaj janë të shtuar në listën e ATK-së të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë. Andaj dyshimet tona janë të mëdha sepse nëse shikohet lista e prezantuar vërehet shumë qartë se ka ndërhyrje, andaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK që ti vërtetoj dyshimet tona se a janë apo jo të sakta.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT-së tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 3 - Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjtë (fasadim te objekteve) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë."* Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 3 - Lista e kontratave duhet te dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E., duke specifikuar emrin e projektit, shumën e kontratës, datën e mbarimit të kontratës dhe tri referenca apo raporte te pranimit teknik. Referencat apo raportet e pranimit teknik duhet te korrespondojne me listën e kontratave".*

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur të FDT-së pasi që në kërkesën e lartpërmendur shkruan shumë qartë se duhet të ofrohen dëshmi se OE ka përfunduar me sukses **kontrata të natyrës së njëjtë (fasadim te objekteve),** ndërsa OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave të cilat i ka prezantuar në ofertë shihet qartë se asnjëra nga kontratat e prezantuara nuk kanë të bëjnë më natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit. Pasi që të gjitha kontratat të cilat i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë kanë të bëjnë me ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje, mirëpo asnjëra nga ato kontrata nuk ka të bëjë me fasadim të objekteve, ndërsa kërkesa siç edhe e cekëm ka qenë shumë e qartë duhet të ofrohen dëshmi se janë kryer kontrata për fasadim të objekteve pra të natyrës së njëjtë.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë nga ana e AK-së, pasi që në këtë rast po diskriminohemi ne si OE i përgjegjshëm dhe që i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se menaxherin e projektit të cilin e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë z. Nysret Hazir Kastrati, nuk e plotëson kërkesën e FDT-së ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa 1- Menaxheri i projektit të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë-Konstruktiv, me së paku 3 vite përvojë punë pas diplomimit, të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku tri (3) projekte te natyrës se njëjte (fasadim te objekteve),* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia 1 - Për menaxher të projektit; CV, diploma e skanuar nga origjinali, vendimi për caktim te menaxherit, kontrata e punës ose parakontrata për projektin ne fjale dhe letër referencat për së paku 3 projekte të përfunduara".* OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë për faktin se noterizimin e diplomës të cilën e ka prezantuar në ofertë në lidhje me diplomën e këtij inxhinieri, është e dt. 30.08.2017 pra ky noterizim i prezantuar nuk vlen sepse siç edhe e dijmë validiteti i noterizimit të një dokumenti zyrtar është maksimumi 6 muaj, ndërsa noterizimi i diplomës së inxhinierit të lartcekur është i vjetër mbi tri vite, andaj edhe nuk duhet të merret si valid.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj edhe është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, mirëpo me këtë veprim të AK-së po shihet qartë favorizimi që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë dhe njëkohësisht diskriminimi që po i bëhet kompanisë tonë.

Ne me dt. 04.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.
Në lidhje me arsyetimin e parë të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim sa i përket listës së punëtorëve nga ATK, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i gjithi i pa bazuar, ku edhe mund të themi që vetë AK-ja po e pranon që në listën e punëtorëve nga ATK-ja e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë ka ndërhyrje, ku janë shtuar tre punëtor.
Pra AK-ja në asnjë rast nuk e ka mohuar pretendimin tonë ankimor duke thënë vetëm se e plotëson OE i rekomanduar për kontratë këtë kërkesë, mirëpo pretendimi ynë ka qenë shumë i qartë ku kemi kërkuar të vërtetohet se a qëndron apo jo pretendimi ynë. Mirëpo AK-ja e ka parë që nuk mund të kundërshtojë këtë pretendim tonin sepse është i gjithi i bazuar pasi që vetëm nëse shikohet lista vërehet qartë se ka ndërhyrje në listën e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Pra arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim në lidhje me pretendimin tonë të parë nuk qëndron dhe është tërësisht i bazuar dhe kërkojmë edhe një herë nga ju si OSHP, ta verifikoni dhe vërtetoni listën e punëtorëve nga ATK-ja, të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Sa i përket arsyes së dytë të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ku e ka cekur se pretendimi ynë në lidhje me listën e kontratave të OE të rekomanduar për kontratë nuk qëndron, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën në lidhje me kontratat e natyrës së njëjtë.
Ne e kemi cekur shumë qartë se OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave të paraqitura shihet qartë se nuk ka prezantuar asnjë kontratë sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Pra kërkesa ka qenë shumë e qartë pra janë kërkuar dëshmi se OE ka përfunduar me sukses **kontrata të natyrës së njëjtë (fasadim te objekteve),** mirëpo që në listën e kontratave të prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë asnjë nga kontratat e prezantuara nuk kanë të bëjnë më natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit. Pasi që të gjitha kontratat të cilat i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë kanë të bëjnë me ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje, mirëpo asnjëra nga ato kontrata nuk ka të bëjë me fasadim të objekteve. Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar, pasi që me këtë veprim të saj AK-ja po e tregon haptas edhe një herë favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me arsyen e tretë të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i **përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE **NNT "Loshi-Design"** si e bazuar,
ANULOHET njoftimi dhe vendimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesën etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*